



REPUBLIKA E SHOIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS
KËSHILLI KOMBËTAR I ARKEOLOGJISË

Nr. 632 Prot.

Tiranë, më 08.05 2019

VENDIM Nr. 112, datë 2.05.2019

Në mbështetje të Ligjit Nr. 27/2018 "Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë", Neni 48 dhe VKM Nr. 786, datë 26.12.2018 "Për miratimin e zonave arkeologjike "A" dhe "B", të qytetit të Durrësit dhe të Planit për Ruajtjen, Mbrojtjen dhe Administrimin e tyre" Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë në mbledhjen Nr. 5, datë 2.05.2019, pasi shqyrtoi Raportin e sondazheve arkeologjike në kuadër të projektit "Pikë shitje me pakicë të karburanteve dhe ambiente shërbimi" në rrugën "Hysen Kërtusha", në zonë arkeologjike "B" Durrës-subjekti "KASTRATI" sh.p.k., paraqitur nga individ i licencuar në arkeologji Z. Eduard Shehi,

VENDOSI:

1. Të miratojë Raportin e sondazheve arkeologjike në kuadër të projektit "Pikë shitje me pakicë të karburanteve dhe ambiente shërbimi" në rrugën "Hysen Kërtusha", në zonë arkeologjike "B" Durrës-subjekti "KASTRATI" sh.p.k., paraqitur nga individ i licencuar në arkeologji Z. Eduard Shehi.
2. Subjekti "KASTRATI" sh.p.k. të vijojë procedurën e shqyrtimit dhe vendimmarrjes në organet përkatëse të qeverisjes vendore.
3. Pas paisjes me lejen përkatëse të lëshuar nga organet e qeverisjes vendore, punimet e gërmimit do të realizohet nën monitorimin ditor të subjektit të licencuar në arkeologji, në vijim të akt-marrëveshjes tre palëshe të lidhur më parë për këtë objekt.
4. Investitori duhet të derdhë detyrimet tatimore për mbikëqyrjen e realizuar nga ASHA, sipas tarifave të miratuara me Urdhërin e Ministrit Nr. 384, datë 21.10.2015 dhe përcaktimeve përkatëse të akt-marrëveshjes tre palëshe.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
6. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi.



SEKRETAR I KKA
RUDINA ZOTO

Adresa: Rruga "Aleksandër Moisiu", Nr. 76, Tiranë

Tel: ++355 04 45 35 855

email: sekretaria.kka@asha.gov.al

Website: asha.gov.al